



INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

PRILL 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse, synon t'i kundërvihet dezinformatave që e vejnë në shënjestër Kosovën, përmes mbikëqyrjes në bazë mujore të botimeve mediale të përzgjedhura që dalin në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran dhe Pravda Report, ndërkaq, në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i mbikëqyr edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë prillit 2020, Russia Today i ka botuar dy lajme, Sputniku asnjë, Meduza asnjë, Russian Insider një, TASS pesë, The Moscow Times një, Newsfornt gjashtë, Unz-i dy, Duran një dhe Pravda Report asnjë lajm, ndërkohë që Sputnik Serbia i ka botuar 53 lajme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, Kremli nuk e pati asnjë, dhe Ministria e Jashtme Ruse i kishte tre postime në ueb-sajtet e veta, e që kishin të bënin me Kosovën.

Një vështrim i kujdesshëm i lajmeve të mbikëqyrura tregon që Sputnik Serbia i kishte tre, Durani një, dhe Newsfronti një artikull të lajmeve që përmbanin dezinformata serioze. Nga ana tjetër, asnjë nga postimet e Ministrisë së Jashtme Ruse nuk kishte përmbajtje dezinformuese.

Dezinformatat e dhëna nga Sputnik Serbia, Durani dhe Newsfronti e synonin projektimin e pavarësisë energjetike të Kosovës si një veprim ilegal, shtetësinë e Kosovës si ilegale dhe si shkelje të së drejtës ndërkombëtare, degardimin e intervenimit dhe të përkrahjes ndërkombëtare të Kosovës, përmes akuzimit të NATO-s dhe Misionit të EULEX-it në Kosovë, dhe këto e bënin pohimin e njëkohësishëm të rrejshëm që gjatë pandemisë COVID-19, BE-ja Kosovën e ka konsideruar si pjesë të Serbisë. Dezinformata e detektuar gjatë kësaj periudhe do të diskutohet dhe dekonstruktohet në pjesën në vijim.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmërimi i Dezinformatës 1

Kryetitulli: Косово се од понедељка отцепљује и од „Електромрежа Србије [Që nga e Hëna, Kosova shkëputet edhe nga “Rrjeti Elektrik i Serbisë,” **Sputnik Serbia, 15 prill, 2020**¹

Ndër të tjera, ky artikull thotë që Operatori i Sistemit Transmetues dhe i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT), dhe Operatori i Sistemit Transmetues të Shqipërisë, më 3 dhjetor 2019 kanë shpallur që në Tiranë e kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e bllokut të sistemit rregullues të energjisë Kosovë–Shqipëri, gjë kjo që është një shkelje e drejtpërdrejtë e Marrëveshjes së Brukselit.

Sipas artikullit, ekspertët në Serbi thanë që kjo e shkel rëndë Marrëveshjen e Energjisë midis Kosovës dhe Serbisë të vitit 2013, të ndihmuar nga BE-ja,² meqë kjo e parashihte që “shteti i rremë i Kosovës” do të jetë një zonë e veçuar energjetike, por me kusht që dy kompani të Serbisë do të formoheshin në Veriun e Kosovës. Themeluesit e këtyre kompanive do të ishin “Elektroprivreda Srbije” [Elektroekonomia e Serbisë] dhe Asociacioni i Komunave Serbe, që nuk është formuar as deri më sot. Marrëveshja e nënshkruar në Tiranë ishte bërë me dijen e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemeve Transmetuese të Energjisë Elektrike.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Ky artikull i parapriu vendimit të Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale (trup i ENTSO-E) të 20 prillit, që i mundësonte KOSTT-it dhe Kosovës që ta braktisin Bllokun Rregullues Energjetik të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë Veriore, dhe që t’i bashkangjiten në Bllokun Rregullues

¹ Косово се од понедељка отцепљује и од “Електромрежа Србије,” [Që nga e Hëna, Kosova shkëputet edhe nga “Rrjeti Elektrik i Serbisë”] Sputnik Serbia, 15 prill 2020, <https://rs.sputniknews.com/politika/202004151122348800-lazna-drzava-otcepljuje-mrezu-kosovo-od-ponedeljka-van-elektromreza-srbije/>

² Agreement between KOSTT and EMS, 2013 [Marrëveshja për Energjinë], 2013, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_per_energjiine.pdf?fbclid=IëAR16zXJrMFy-Ë3K7NKOtZm5hvE8SIWHEoTnj-pmgNcLMpRbWAYCDXOTdKNI

Energjetik Kosovë –Shqipëri.³ Në këtë mënyrë, Marrëveshja i hap rrugë KOSTT-it që të integrohet në tregun rajonal të energjisë elektrike, si dhe që të merr pjesë në Shkëmbimin Shqiptar të Energjisë (APEX – Albanian Power Exchange), dhe vendimi i ENTSO-e është mbështetur në “Marrëveshjen për Energjinë të nënshkruar midis Kosovës dhe Serbisë në vitin 2013, si pjesë e dialogut të ndihmuar nga BE-ja në Bruksel.⁴ Për më tepër, kjo marrëveshje e funksionalizoi investimin e Qeverisë së Gjermanisë që përmbledhet në 75 milionë €, në ndërlidhjen e linjës energjetike 400 kV midis Kosovës dhe Shqipërisë, i cili ishte përfunduar disa vite më parë.⁵

Lajmërim i Dezinformatës 2

Kryetitulli: Kosovo authorities try to defend integrity of their own pseudo-state [Autoritetet Kosovare përpiqen ta mbrojnë integritetin e vetë pseudo-shtetit të tyre], Newsfront, 18 prill 2020⁶

Ky artikull pohon që më 17 shkurt 2008, Kosova, si një krahinë autonome e Serbisë, me përkrahjen e drejtpërdrejtë të Washingtonit dhe të Berlinit, e shpalli deklaratën e vet të pavarësisë, duke e shkelur në këtë mënyrë të Drejtën Ndërkombëtare, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, dhe Marrëveshjen e Helsinkit. Sipas artikullit “kjo e ka krijuar një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm, ashtu siç Moska ka paralajmëruar vazhdimisht. Historikisht, nuk ka kaluar shumë kohë, dhe tash vetë autoritetet kosovare janë duke u përpjekur ta mbrojnë integritetin e pseudo-shtetit të tyre,” ndërkohë që artikulli nuk e ofron madje as edhe një shenjë të vetme të asaj se si ato janë duke e bërë këtë.

³ Balkan Green Energy News, KOSTT: ENTSO-E e përkrah daljen e Kosovës* nga blloku kontrollues i udhëhequr nga EMS e Serbisë, 21 prill 2020, <https://balkangreenenergynews.com/kostt-entso-e-backs-kosovos-exit-from-control-block-lead-by-serbias-ems/>

⁴ Për hetim të mëtutjeshëm shih: “Bilateral relations between Kosovo and Serbia regarding energy sector” [Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës e Serbisë lidhur me sektorin e energjisë], Research Institute of Development and European Affairs (RIDEA), tetor 2019, http://www.ridea-ks.org/Articles/3/Images/29-01-2019/22628_Bilateral_relations_between_Kosovo_and_Serbia_regarding_the_Energy_Sector.pdf

⁵ Shih deklaratën e Ambasadës Gjermane në Kosovë, të postuar në faqen e saj në Facebook, më 20 prill 2020, <https://www.facebook.com/germany.in.kosovo>

⁶ <https://en.news-front.info/2020/04/18/the-kosovo-authorities-are-trying-to-defend-the-integrity-of-their-own-pseudo-state/>

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Para së gjithash, dhe mbi të gjithat, nuk është madje as edhe një rezolutë e vetme e KB që Kosovën ia jep Serbisë si të tillë; e vetmja që është në fuqi (1244) Kosovën e merr si pjesë të Republikës tash jo-ekzistuese Federale të Jugosllavisë. Mbetja e Federatës, Republika Federale e Jugosllavisë, më vonë Unioni i Serbisë dhe Malit të Zi, po ashtu u shpërbë në vitin 2006, kur 55.53% të qytetarëve të Malit të Zi në referendum votuan për pavarësi, gjë kjo që e përfundoi shpërbërjen e saj, dhe e mjegulloi në tërësi çfarëdo qoftë lidhje ligjore midis Kosovës dhe Serbisë. Së dyti, deklarata e pavarësisë së Kosovës ishte një rezultat i procesit negociator për statusin e Kosovës që është udhëhequr nga i Dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Presidenti Marti Ahtisaari, në të cilin Rusia në ekipin e Presidentit Ahtisaari ishte e përfaqësuar me diplomatin e saj të nivelit të lartë, z. Peter Ivanov. Më 2 shkurt 2007, Presidenti Ahtisaari e paraqiti Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që e parashihte pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën,⁷ i cili u përkrah nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon⁸ dhe nga Kosova, dhe u refuzua nga Serbia.⁹

Në fund, më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) e dha mendimin këshillues që e konfirmonte që deklarata e pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008, nuk e ka shkelur të Drejtën Ndërkombëtare.¹⁰ Prandaj, që të gjitha pretendimet e këtij artikulli janë të rreme. “Precedentët” që i pohon artikulli janë intervenimet ushtarake ruse në rajonet gjeorgjiane të Osetisë dhe Abkhazisë, dhe aneksimi i Krimesë.

⁷ Shih tekstin e plotë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës:

https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf

⁸ UN Report Recommends 'Supervised Independence' For Kosovo [Raporti i KB Rekomandon 'Pavarësinë e Mbikëqyrur' për Kosovën], Radio Free Europe, 26 mars 2007 <https://www.rferl.org/a/1075514.html>

⁹ Reuters, Kosovo says Yes to U.N. plan, Serbia says No [Kosova i thotë Po planit të KB, Serbia i thotë Jo], 2 shkurt 2007, https://www.reuters.com/article/idUSL02151096.CH_.2400

¹⁰ International Court of Justice. Advisory Opinion on the accordance with international law of the unilateral declaration of independence of Kosovo [Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Mendimi Këshillues për pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të deklaratës unilaterale të pavarësisë së Kosovës], 22 korrik 2010, <https://www.webcitation.org/5rRB9e3bz?url=http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

Lajmërim i Dezinformatës 3

Kryetitulli: Кад је криза, за ЕУ је Косово – српско [Kur është Krizë, për BE-në Kosova është Serbe], Sputnik Serbia, 1 prill 2020¹¹, dhe, EU Demands Serbia to Help Kosovo During Corona Virus But Restricts Assistance of Bosnian Serbs [BE-ja i Kërkon Serbisë që ta Ndhimojë Kosovën gjatë Korona Virusit, por e Kufizon Ndhimën e Serbëve të Bosnjes], The Duran, 3 prill 2020¹²

Që të dy artikujt, që janë pothuaj identikë, ndër të tjera thonë që “Në kohë krize, BE-ja e shpall që Kosova është në të vërtetë përgjegjësi e Serbisë. Kjo natyrë joparimore e BE-së udhëhiqet vetëm nga interesat e anëtarëve të saj kryesorë, dhe synon që përgjegjësinë mjekësore për krahinën e arratisur të Kosovës t’ia lë në duar Serbisë.” Për më tepër, këta artikuj pohojnë që “BE-ja nuk ka bërë asgjë për ta shtypur separatizmin shqiptar. Në të vërtetë, BE-ja e thekson ilegalitetin e pavarësisë së Kosovës duke i pozicionuar atje mbi 1.000 oficerë policie nën mandatin e Misionit Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë, ku të gjitha vendet anëtare, me përjashtim të Greqisë, Qipros, Rumanisë dhe Sllovakisë, e njohin pavarësinë e Kosovës.”

Është interesante që artikulli i The Duran, pavarësisht nga fakti që e përsërit atë të Sputnik Serbia, atë nuk e përmend fare, dhe autorësinë ia jep Paul Antonopoulos, Hulumtues në Qendrën për Studime Sinkretike (<https://syncreticstudies.com/paul-antonopoulos/>), ndërkohë që cilësimet e sipërpërmendura në artikullin e Sputnik Serbia janë citime që janë marrë nga analisti politik serb pro-rus, Dragomir Andjelković.

¹¹ Кад је криза, за ЕУ је Косово – српско [Kur është Krizë, për BE-në Kosova është Serbe], Sputnik Serbia, 1 prill 2020.

¹² EU Demands Serbia to Help Kosovo During Corona Virus But Restricts Assistance of Bosnian Serbs [BE-ja i Kërkon Serbisë që ta Ndhimojë Kosovën gjatë Korona Virusit, por e Kufizon Ndhimën e Serbëve të Bosnjes], The Duran, 3 prill 2020:

<https://theduran.com/eu-demands-serbia-to-help-kosovo-during-coronavirus-but-restricts-assistance-of-bosnian-serbs/>

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) BE-ja e shpall Kosovën si përgjegjësi të Serbisë gjatë krizës së COVID-19

Artikulli paraqet thirrje në Grupin Punues për Kapitullin 35 të Konventës Kombëtare Serbe të Bashkimit Evropian, që i grumbullon organizatat e shoqërisë civile në Serbi të specializuara në fushat e mbuluara nga 35 kapitujt negociues, që u është drejtuar autoriteteve shëndetësore të Serbisë dhe të Kosovës, duke e kërkuar bashkëpunimin e tyre gjatë pandemisë COVID-19, si një thirrje të Bashkimit Evropian, duke e keq-cituar në një mënyrë manipuluese artikullin e Observerit të BE-së të 30 marsit 2020, “Serbian CSOs call for cooperation with Kosovo in combating COVID-19” [“Thirrja e CSO-ve serbe për bashkëpunim me Kosovën në luftimin e COVID-19”].¹³ Për më tepër, as thirrja e CSO-ve serbe, dhe as edhe një pohim i vetëm i BE-së, Kosovën nuk e ka shpallur si përgjegjësi e Serbisë gjatë krizës së COVID-19.

b) BE e mbështet ilegalitetin e pavarësisë së Kosovës përmes EULEX-it

Artikulli e fajëson BE-në për atë që nuk e shtyp “separatizmin shqiptar,” duke e akuzuar shumicën e vendeve të BE-së për atë që e kanë pranuar Kosovën. Për më tepër, Misioni i EULEX-it është pranuar nga të gjithë anëtarët e BE-së, përfshirë edhe ato mos-njohëse të Kosovës,¹⁴ dhe në këtë mision kanë marrë pjesë të gjitha vendet e BE-së pos Spanjës dhe Qipros, së bashku me Shtetet e Bashkuara, Turqinë, Norvegjinë dhe Zvicrën.

¹³ EU Observer, “Serbian CSOs call for cooperation with Kosovo in combating COVID-19” [Thirrja e CSO-ve serbe për bashkëpunim me Kosovën në luftimin e COVID-19], 30 mars, 2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/03/30/serbian-csos-call-for-cooperation-with-kosovo-in-combating-covid-19/>

¹⁴ Shih Vendimin e Këshillit të Evropës (CFSP) 2018/856 të 8 qershorit 2018, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=CELEX:32018D0856>

Lajmërim i Dezinformatës 4

Kryetitulli: Брутална честитка Милачића НАТО-у: Ти си црна рупа цивилизације [Urimi mizor i Millaçiqit për NATO-n: Ti je një vrimë e zezë e qytetërimit] Sputnik Serbia, 4 prill 2020¹⁵

Në këtë artikull Sputniku i bart “urimet” e Marko Millaçiqit, Kryetar i Malit të Zi të Vërtetë (një parti politike pro-ruse kjo), për NATO-n në Përvjetorin e saj të 71-të. Ndër të tjera, artikulli citon që Millaçiqi të ketë thënë: “Ti ke luftuar këtu [në Jugosllavi] për një dekadë, dhe më pas, në përvjetorin tënd të 50-të e gjete një viktimë dhe një arsye për të ekzistuar. Ashtu siç Diana Johnson¹⁶ e ka thënë për bukuri, verzioni zyrtar nuk është i vërtetë që Kosova e kishte një problem, dhe që ti e ofrove një zgjidhje, përkundrazi – ti e pate një problem, problemin e arsyes së ekzistencës tënde, dhe Kosova ishte zgjidhja jote. Kjo është pse ti e sulmove RFJ-në. Kjo është pse na bombardove. Nuk ka patur ndonjë dhuratë më të mirë për ditëlindjen tënde të 50-të se bombardimi i vendit tonë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli e mohon faktin që NATO-ja intervenoi në Kosovë vetëm pas shtjerrjes së të gjitha mjeteve diplomatike për gjetjen e zgjidhjes politike me Beogradin që e shfuqizoi në mënyrë (jo)kushtetuese autonominë e saj në vitin 1989.¹⁷ Për më tepër, në këto përpjekje diplomatike, Perëndimi ishte po ashtu duke punuar bashkarisht edhe me Rusinë, në formatin multilateral të

¹⁵ Брутална честитка Милачића НАТО-у: Ти си црна рупа цивилизације [Urimi mizor i Millaçiqit për NATO-n: Ti je një vrimë e zezë e qytetërimit], Sputnik Serbia, 4 prill 2020, <https://rs.sputniknews.com/regioni/202004041122261920-brutalna-cestitka-milacica-nato-u-ti-si-crna-rupa-civilizacije-video/>

¹⁶ Diana Johnson është një autore ultra-majtiste që pohon që “intervenimet humanitare” janë një lloj i ri i imperializmit. Në librin e saj *Fools’ Crusade: Yugoslavia, Nato, and Western Delusions* [Kryqëzatat e Budallenjve: Jugosllavia, Nato dhe Iluzionet Perëndimore], Pluto Press, 2002, ajo pohon që “identifikimi i myslimanëve si viktima të pambrojtura, dhe i serbëve si përbindësja gjenocidalë e rriti frikën dhe urrejtjen brenda Jugosllavisë, dhe e përgatiti rrugën që fuqia të zhvendosej nga popujt e rajonit në agjenci të tilla ndërkombëtare si NATO-ja,” dhe që “Lufta e Kosovës” ishte në realitet një model për dekonstruktimin e ardhshëm të vendeve që shihen si një kërcënim potencial ndaj hegjemonisë së “bashkësisë ndërkombëtare” që aktualisht është duke u ripërkufizuar ashtu që t’i përjashtojë apo marginalizojë të gjithë pos atyre që janë konform me interesat e Shteteve të Bashkuara.” <https://www.amazon.com/Fools-Crusade-Yugoslavia-Western-Delusions/dp/158367084X>

¹⁷ Për hollësi të mëtutjeshme shih: Marc Weller, The Rambouillet Conference on Kosovo [Konferenca e Rambouillet-së për Kosovën], International Affairs, Vol. 75, No.2, prill 1999, fq. 118-221

njohur si “Grupi i Kontaktit,” i cili u krijua si përgjigje ndaj luftës së përgjakshme në Bosnje. Serbia e refuzoi marrëveshjen e Rambouillet-së¹⁸ të marsit 1999, dhe e zbotoi operacionin luftarak “Operacioni Patkoi” kundër popullatës civile shqiptare, me qëllim që ta shpopullojë Kosovën përmes terrorit.¹⁹ Për më tepër, Millaçiçi e shpërfill faktin që para intervenimit të NATO-s, forcat jugosllave tashmë i kishin vrarë mbi 2.000, burgosur mbi 1.200, dhe zhvendosur rreth 300.000 kosovarë shqiptarë,²⁰ dhe që në këtë mënyrë, jo vetëm që e kishte mohuar konfliktin politik dhe shtypjen e Beogradit mbi kosovarët shqiptarë, por e kishte mohuar vetë katastrofën njerëzore që ishte duke ndodhur, gjë kjo që pas refuzimit të Marrëveshjes së Rambouillet-së mund të trajtohej vetëm përmes një intervenimi të armatosur nga Aleanca Veri-Atlantike, si e vetmja organizatë në Evropë që ishte në gjendje ta kryente një operacion të tillë kundër regjimit të vrazhdë të Millosheviqit.

¹⁸ Shih tekstin e plotë të Marrëveshjes së Rambouillet-së: https://1997-2001.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html

¹⁹ Ky plan NATO-s iu zbulua nga Bullgaria, <https://balkaninsight.com/2012/01/10/bulgaria-leaked-milosevic-ethnic-cleansing-plan/>

²⁰ Eric Herring, From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath [Nga Rambouillet-ja deri te marrëveshja e Kosovës: Lufta e NATO-s kundër Serbisë dhe më pas], The International Journal of Human Rights, Routledge, October 2007.